

**R R E G U L L O R E**  
**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË**  
**KORRJEVE SHIRJEVE**



Në bazë të nenit 3 dhe 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/45 mbi vetqeverisjen e komunave të Kosovës dhe nenit 19 të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me datën 18.07.2002, miratoi këtë:

## **R R E G U L L O R E** **PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË KORRJE – SHIRJEVE**

### **Neni 1**

Duke u nisur nga fakti se korrja dhe shirja e grurit dhe e drithrave tjera bëhet brenda një kohe të shkurtër edhe organizimi i punëve duhet të jetë në nivel të duhur.

Me vonim të korrjes prej 5-10 ditë, rendimentet zvoglohen prej 4 -10 %.

Korrja dhe shirja duhet bërë atëherë, kur konstatohet se kultura në fjalë gjendet në fazën e pjekurisë teknike ( të dyllt).

Në nivel Komunal do të caktohet komisioni për përcjelljen e korrje – shirjeve, i cili bënë njikohësisht edhe kontrollimin teknik të makinave për korrje – shirje.

### **Neni 2**

Çmimi i korrje - shirjeve është preferuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Drejtorati i Zhvillimit Rural të Komunës së Prishtinës, që do të jetë, 65 €pa lidhje të kashtës dhe 75 € me lidhje të kashtës, për një hektar.

### **Neni 3**

Autokombanjerët duhet t'u përmbahen rregullave të korrje – shirjeve, siq janë :

- që korrjen dhe shirjen ta kryejnë në afatin e paraparë dhe me cilësi e cila siguron që humbja e drithit të mos jetë më e madhe se 3 %,
- lartësia e korrjes ( sernishtës) të mos jenë më e lartë se 15 cm,
- të respektojnë çmimin e preferuar për kryerjen e korrje - shirjes.
- që me kohë të bëjnë të gjitha përgatitjet teknike dhe të tjerat për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve.

Autokombanjerët duhet të trajtojnë të gjithë bujqit në mënyrë korrekte dhe pa asnjë dallim, të mbajnë evidence të saktë për korrje – shirje, në autokombajë duhet të jetë e shënuar qartë shenja kundër zjarrit, e cila duhet edhe të respektohet nga të gjitha palët, të posedoj aparatin zjarrfikës dhe mjete tjera ndihmëse.

#### **Neni 4**

- Prodhuesit bujqësor janë të obliguar :
- që me kohë të përgatisin ngastrat e tyre për kryerje pa pengesa të korrjeve dhe shirjeve ( pastrimin e barojave të këqia, shkurreve, eliminimin eventual të gardhiqeve dhe pengesave tjera )
  - që të sigurojnë rrugët kaluese te ngastrat ( mbyllja e kanaleve, rrafshimi i terrenit).

#### **Neni 5**

Për kushtet e korrje – shirjeve autokombanjerët dhe bujqit duhet të informohen me kohë.

#### **Neni 6**

- Organi kompetentë i administrates nga neni 1 i kësaj Rregulloreje është i autorizuar:
- që të kontrollojë respektimin e afateve të përcaktuara për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve, gjendjen e rregullt teknike të makinave korrëse – shirëse, orarin e kryerjes së korrjeve dhe shirjeve, gjendjen e rregullt të instrumenteve për matje, mbrojtjes në punë, mjeteve mbrojtëse kundër zjarrit e të ngjajshme,
  - që të ndaloj punën e makinave ( autokombajave ), për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve në rastet e gjendjes jo të rregullt teknike, ose të humbjes së drithit mbi 3 %.

#### **Neni 7**

Me denim me të holla prej 100 €deri 200 €do të dënohet pronari i makinës për kryerjen e korrjeve dhe shirjeve, nëse punon me kundërshtim me dispozitat e nenit 3 të kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 8**

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Drejtorati për Zhvillim Rural dhe inspektorët komunal të bujqësisë.

#### **Neni 9.**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendit i Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
NR. \_\_\_\_\_ DT. \_\_\_\_\_

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Dr.Salih Gashi**